

**Fjala e z. Petrit Vasili,
Deputet në Kuvendin e Shqipërisë**

I nderuar z. Nikollaj,
I nderuar z. Veliaj,
Të nderuar pjesëmarrës,

Kongresi i V i KSSH është një ngjarje shumë e rëndësishme në jetën sindikale të KSSH. Është një momenti i rëndësishëm për zgjedhjet por dhe një moment për analizë të thellë të asaj që KSSH-ja ka bërë në vite, dhe të asaj që ka në plan për të ardhmen.

Përgjithësisht ka ekzistuar modeli që sindikatë do të thotë luftë, betejë dhe përplasje. Sigurisht që ky instrument i sindikatave është mjet presioni i fortë publik, por edhe sindikatat kanë bërë një ndryshim të rëndësishëm të profilit të tyre sepse dhe kohërat e shoqëritë kanë ndryshuar.

E vetmja sindikatë në Shqipëri e cila ka demonstruar një evoluim thellësisht pozitiv dhe evropian është KSSH-ja, duke vepruar simotrat e saj në europë e gjetkë për të kaluar nga reagimi i fortë publik në parandalim e një plage që hapet.

Roli i sindikatës është bërë i pazëvendësueshëm edhe për ato rezultate që ajo ka prodhuar me prezencën e saj. Është vendi për të thënë që sindikata më shumë se në rrugë e bulevard janë të rëndësishme negociatat. Kemi patur fatin të diskutojmë nisma të mëdha ligjore të cilat kanë patur sukses në ecurinë e tyre dhe ne promovimin publik, pasi sindikata ka qënë aty si mbrojtëse e interesave të punëtorëve, ka qënë aty edhe me alternativa konkrete edhe të karakterit ligjor, dhe të formulimeve përkatëse ligjore duke qënë kështu një partner i kualifikuar dhe debutuese e kualifikuar.

KSSH ka patur komponente të rëndësishëm bashkëpunimi; kualitetin e madh profesional, edhe të ulurit në tavolinë, por edhe forcën e demonstrimit publik. Kjo do të thosha se funksionon në mënyrë të shkëlqyer në jetën e sindikatës dhe ky profil i fortë shkon në drejtim të thellimit të tij se dhe figurat e përzgjedhura në proceset zgjedhore tuaja demonstrojnë kualitetin e duhur. Sindikatën e bëjnë anëtarët e saj të jetë e fuqishme, të realizojë qëllimet e saj. Pa një fuqi të tillë përfaqësimi dhe negociimi nuk mund të ketë rezultate të në interes të punëtorëve. Në cilësinë e anëtarit të Parlamentit shqiptar jam këtu për të konfirmuar vullnetin për të ecur përpara në ato element të reformave të cilët lehtësojnë jetën e

punonjësve. Nuk është e lehtë të ndërmarrësh reforma dhe në kushte të krizës ekonomike, por dhe të ruash interesat e punonjësve. Vështirësitë i zgjidh kualiteti, zotësia për të qenë argumentues, por edhe zotësia për të harmonizuar këta element. Ne jemi këtu për të mbështetur çdo gjë pozitive që KSSH ka realizuar. Nuk jemi për të ndryshuar rolet por për të vazhduar oponencën e fortë konstruktive të Konfederatës nga njëra anë e cila i bën mirë edhe qeverisjes dhe njëkohësisht rolit të fortë të qeverisjes për të patur dëshirën për dialog.

Viti i parë i qeverisjes tonë ka qënë një shembull i mirë i dialogut ndërmjet gjithë partnereve sindikalë për çdo nismë konkrete. Dialogu dhe debati ne tavolinë ka qënë dukshëm frytdhënës. Aftësia e mazhorancës për të reflektuar është një nga aftësitë dhe cilësitë më të vyera që ajo ka përkundrejt një mazhorance kokfortë apo arrogante ku çdo lloj mendimi e ngjyrosin politikisht ose e refuzojnë.

Jam i lumtur për bashkëpunimin e kahershëm me KSSH edhe në ditë të vështira ku dhe atëherë kemi folur për nisma konkrete të cilat për shkak të konteksteve politike here pengohen here ecin ngadalë, por e rëndësishme ka qënë që kemi komunikuar e dialoguar.

Kjo frymë dhe ky pozivitet evropian që sindikata e ka bërë dimension të vetes do ta udhëheqë edhe në të ardhmen dhe do të udhëheqë edhe të mandatuarit ne këtë Kongres, do te udhëheqë edhe profilin shume të fortë që KSSH ka në ndihmë së pari të punonjësve që do të thotë në ndihmë të njerëzve për të jetuar më mirë.

I uroj suksese Kongresit dhe gjithë pjesëmarrësve për të pasur ditë të frytshme dhe për të arritur objektivat e përcaktuara. Faleminderit.